



Prania / Presence Bashkëpunues / Collaborator Kryesues / Chairperson	23.06.2023	3	viti / year
Organizata / Organization Org. / Org.	Prof. No.	Shtesa / Addendum Sht. / Sht.	Sasia / Quantity Kant./ Cant.
SKM/SJK	4898/2023		1/6



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.683/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.683/2023 të datës 27.04.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër Vendimit me numër KD./019 të datës 18.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër KD.nr.019/2023 i datës 18.04.2023 i Komisionit Disiplinor në Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- II. OBLIGOHET Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë rishqyrtimin e lëndës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.
- III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, t'i ndërmerret të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij Vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Kontratës se punës të datës 10.04.2018 në pozitën "Udhëheqës i Pavionit" në Qendrën Korrektuese ne Dubravë.

Me datë 20.03.2023 sipas vendimit është formuar komisioni për hetimin e Incidenteve ne Pavijonin 3 në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i cili komision më datë 27.03.2023 ka përgatitur raportin përfundimtar me numër protokolli 63/23.

Sipas shkresës të datës 20.03.2023 të Zëvendësueses se Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Dubravë është obliguar Komisioni hetimor që të identifikojë shkaqet e rrahjeve ne mes te burgosurve në Pavijonin 3, të identifikojë shkaktaret e krijimit te këtyre incidenteve apo grupet e kërcënimit të sigurisë që rezultojnë në rrahjet e vazhdueshme si dhe të hetohet se stafi i Pavijonit a i ka zhvilluar të gjitha procedurat e brendshme të zyrtarëve në Qendrën e Korrektuese në Dubravë, gjegjësisht procedurat e sigurisë, vendosjen e te burgosurve ne krah - dhoma, trajtimin - mbikëqyrjen e lëvizjeve të tyre.

Më datë 27.03.2023 Komisioni Hetimor ka nxjerr Raportin Zyrtar me protokolli 63/23 i cili i është dërguar Zëvendësueses se Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Komisioni Hetimor në bazë të raportit të cekur si më lare ka dhënë konstatimin sipas të gjeturave duke cituar se: „Në bazë të gjendjes se krijuar në Pavijonin 3 dhe keq menaxhimit të strukturës menaxhuese të ndërmerren masa disiplinore ndaj udhëheqësit të Pavijonit 3 si dhe të ndërrohen Udhëheqësi, Mbikëqyrësit dhe disa nga stafi” .

Zëvendësuasi i Zëvendës Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Dubravë më datë 28.03.2023 ka paraqitur kërkesë me numër 65/23 për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit në Komisionin Disiplinor, për shkak të dyshimit se ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, bazuar në Raportin e Hetimit te incidenteve në Pavijonin 3. Më datë 03.04.2023 Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës i ka përcjell ankuesit ftesën për intervistën e caktuar më datë 05.04.2023 në orën 10:30 të cilën ftesë ankuesi e ka pranuar më datë 03.04.2023. Më tutje Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 18.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër KD.nr.019/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, dhe 3.3, si dhe neni 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke i shqiptuar masën disiplinore “ Ndalimi 20% e pagës për periudhë dy (2) muaj”.

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datë 27.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Sl. e D. Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.nr.019/2023 të datës 18.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se vendimi nen shenjen KD.nr.019/2023 i datës 18.04.2023 i Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës është i kundërligjshëm, diskriminues dhe demotivues, sepse me këtë vendim përveç që jam dëmtuar financiarisht, jam dëmtuar edhe emocionalisht dhe një shqetësim shume te madhe a kanë përjetuar edhe familja.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 30.05.2023 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesa, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Po ashtu, Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë me 09.06.2023 ka nxjerrë Vendimin VK/2023 më numër prot:4655/2023, përmes të cilit, ankesës së ankuesit ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër te protokollit 3867/2023 te datës 27.04.2023 te parashtruar nga ankuesi në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.019/2023 të datës 18.04.2023 të Komisionit Disiplinore në Shërbimin Korrektues; Raportin 3 mujore të datës 15.03.2023 për rastet e rrahjes në pavijon 3; Raportin ditore të datës 27.12.2022; Raportin ditore të datës 28.12.2022; Raportin e vitit 2022 nga data 01.01.2022 deri me datën 30.12.2022; Raportin ditore te datës 11.01.2023; Raportin javor nga data 28.02.2023 deri me datën 04.03.2023; Kërkesën për përgjigje ne ankesë te datës 04.05.2023; Përgjigjen ne ankesë te datës 30.05.2023; Kontratën e punës për kohe te caktuar te datës 10.04.2018; Rekomandimin për përtëritjen e kontratës; Përshkrimin e detyrave te punës te datës 09.06.2008; Flete kthesën e datës 19.04.2023; Vendimin me numër KF.nr.019/2023 te datës 18.04.2023; Ftesën për intervistë te datës 03.04.2023; Kërkesën me numër KD/19 te datës 30.03.2023 për inicimin e procedurës disiplinore; Raportin përfundimtar te datës 27.03.2023; Raportin ditor te datës 11.01.2023; Raportin e vitit 2022 nga data 01.01.2023 deri me datën 30.12.2022; Raportin ditore 27.12.2022; Procesverbali lidhur me te intervistuarin per incidentin ne pavijonin nr.3; Procesverbali lidhur me te intervistuarin per incidentin ne pavijonin nr.3; Procesverbalin lidhur me te intervistuarin per incidentin ne pavijonin nr.3; Shkresën e datës 20.03.202 lidhur me hetimet për incidentet ne pavijonin nr.3; Procesverbalin e intervistës me stafin e Procesverbalin e mbajtur me datën 15.04.2023; Vendimin nen shenjen VK/2023 të datës 09.06.2023 te Kryetarit te Këshillit te Pavarur mbikëqyrës për shërbim Civil te Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ekziston baza ligjore qe lënda të kthehet ne rishqyrtim, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.nr.019/2023 i datës 18.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon se vendimi është i kundërligjshëm, diskriminues dhe demotivues, sepse Komisioni Disiplinor nuk ka marre për bazë shkresat zyrtare me shkrim të cilat ankuesi i ka drejtuar tek menaxhmenti i institucionit, në të cilat janë evidentuar shkaqet dhe veprimet te cilat duhet te ndërmerren ne mënyrë që te vendoset rregulli dhe siguria ne pavijon .

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Hetimor më datë 27.03.2023 ka nxjerr Raportin Zyrtar Hetimor me protokollin 63/23 i cili i është dërguar Zëvendësueses së Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, me që rast janë dhënë konstatime sipas të gjeturave si në vijim: „Në bazë të gjendjes së krijuar në Pavijonin 3 është e nevojshme dhe e domosdoshme të ndërrohen kohe pas kohe stafi konkretisht Udhëheqësi, Mbikëqyrësit dhe disa nga stafi”. Udhëheqësi i pavijonit nuk ka bërë shënim zyrtar për moszbatimin e urdhrave të tij nga ana e stafit andaj për shkak të gjendjes së krijuar në Pavijonin 3 dhe keq menaxhimit të strukturës menaxhuese të ndërmerren masa disiplinore ndaj udhëheqësit të Pavijonit 3.

Me ç’rast sipas provave të lëndës, si rezultat i këtij raporti është bërë edhe inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit, konkretisht Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, gjegjësisht Zëvendësuesi i Zëvendës Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Dubravë me datë 28.03.2023 ka kërkuar nga Komisioni Disiplinor inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit për shkak të dyshimit se ankuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa si përfundim i kësaj procedure disiplinore Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 18.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër KD.nr.019/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpall përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, dhe 3.3, si dhe neni 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë duke i shqiptuar masën disiplinore “ Ndalimi 20% e pagës për periudhë dy (2) muaj”, e përcaktuar me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me arsyetimin se i njëjti ka shkelur dispozitat e nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik sipas gjetjeve të Raportit Hetimor të datës 27.03.2023 të nxjerrë nga Komisioni Hetimor i themeluar për hetimin e Incidenteve në Pavijonin 3 në Qendrën Korrektuese në Dubravë sepse i njëjti ka dështuar në menaxhimin e situatave duke mos përdorur masa preventive para se të ndodhin incidentet respektivisht për shkak të keq menaxhimit të situatave nga ankuesi si Udhëheqës i Pavijonit.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues i Kosovës në seancën e procedurës disiplinore të mbajtur me datë 05.04.2023, ka ftuar vetëm ankuesin ndërsa jo edhe iniciuesin e procedurës disiplinore dhe anëtarët e Komisionit Hetimor të cilit e kishin hartuar raportin e të datës 27.03.2023, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë nenit 12 paragrafi 4 dhe 5 lidhur me mbajtjen e seancave disiplinore ka përcaktuar se: “Seancat e Komisionit disiplinor janë të mbyllura përpos nëse parashihet ndryshe me Ligjin në fuqi dhe mbahen me praninë fizike të të gjithë anëtarëve siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. 5. Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ”pasi që në kuptim të nenit 94 dhe 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes. 95.1 Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t’u dëgjuar”, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit KD.nr.019/2023 të datës 18.04.2023, duke mos i ftuar në seancë palët në procedurë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjore si dhe në kundërshtim edhe me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve

Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, prandaj në rastin konkret Komisioni Disiplinor është dashur të veprojë sipas detyrës zyrtare dhe të verifikojë dhe shqyrtojë çdo rrethanë juridike, fakt apo provë relevante dhe të dëgjoj variantin e palëve në procedurë për çështjen e ngritur.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të provave të lëndës, konstaton se Komisioni Disiplinor i cili kishte mbajtur seancën e datës 05.04.2023 dhe kishte nxjerr aktin sipas të cilit ankuesi është shpallur përgjegjës duke mos ftuar palët në procedurë, duke mos shqyrtuar dhe analizuar në procedurë administrative asnjë konstatim të dhanë nga Komisioni Hetimor, janë veprime që bien ndesh me dispozitat e dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku shprehimisht rregullohet se: *"1. Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 3. Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.1. Merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; 3.2. Rishikon dokumentacionin përkatës; 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; 3.4. Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes"* ngase sipas detyrës zyrtare Komisioni Disiplinor ka qenë i obliguar të ftojë në seancë ankuesin, iniciuesin e procedurës disiplinore dhe të tre (3) anëtarët e Komisionit Hetimor të cilët e kishin hartuar Raportin e datës 27.03.2023 për të njohur me variantin e tyre të ngjarjes, mirëpo Komisioni Disiplinor gjegjësisht të njëjtën kohë ka ushtruar detyrat dhe kompetencat e tre (3) institucioneve të tjera të përcaktuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, nga rrjedh se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së vendimit KD.nr.019/2023 të datës 18.04.2023, ka shkëlur dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 10 paragrafi 6 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: *"Për procedurën dhe vendimmarrjen e komisionit disiplinor, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative"* nga rrjedh se në rastin konkret Komisioni Disiplinor ka shkëlur në dispozitat e lartcekura ligjore të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Po ashtu Komisioni disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.019/2023 të datës 18.04.2023 nuk ka arritur të shqyrtoj në mënyrë të drejtë provat materiale të lëndës dhe nuk ka arritur të konstatoj nëse janë plotësuar kushtet ligjore apo elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë përgjegjësia e ankuesit në këtë çështje juridike, si rrjedhojë nuk janë shqyrtuar elementet e nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mbi këtë bazë sipas Kolegjit të Këshillit, Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.nr.019/2023 të datës 18.04.2023, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë , si dhe në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që arsyetimi i vendimit është kundërtshënës me vetveten, dhe si rrjedhojë i njëjti vendim është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme"*, prandaj i njëjti është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa lënda e ankuesit ndërlidhur me procedurën e iniciuar disiplinore është kthyer në

rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor, pasi që Kolegji i Këshillit për shkak të lëshimeve procedurale nga Komisioni Disiplinor të përcaktuara si më lartë, nuk ka mundur të konstatoje saktë gjendjen faktike nëse ankuesi ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoj se Vendimi me numër KD.nr.019/2023 i datës 18.04.2023 i Komisionit Disiplinor në Shërbimit Korrektues të Kosovës, është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale, dhe meqë u konstatua se i njëjti është i paligjshëm, atëherë Kolegji i Këshillit obligon Komisioni Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës që në riprocedurë të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe të mënjanojë shkeljet procedurale dhe materiale, si dhe të merr parasysh konstatimet si në këtë vendim duke i eliminuar të gjitha këto shkelje, të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin përkatës.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.683/2023

Ilire **MEHMETI-SHAQIRI**

*Procesmbajtëse*

Malsore **GASHI-BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së